



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.172

14 dhjetor

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i Kuvendit nr.20, datë 10.12.2009	Për përcaktimin e masës së përfitimit financiar mujor për shërbimin e transportit të deputetëve	7645
Vendim i KM nr.1103, datë 14.11.2009	Për miratimin e planit të veprimit të strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafikeve dhe terrorizmit	7646
Vendim i KM nr.1151, datë 25.11.2009	Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë	7677

VENDIM
Nr.20, datë 10.12.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË PËRFITIMIT FINANCIAR MUJOR PËR SHËRBIMIN
E TRANSPORTIT TË DEPUTETËVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 2 pika 2 të ligjit nr.10 160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”, si dhe të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e deputetëve Viktor Gumi, Gent Strazimiri, Florian Mima dhe Paulina Hoti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Masa e përfitimit financiar mujor për çdo deputet për shërbimin e transportit përcaktohet sipas lidhjes bashkëngjitur këtij vendimi.

II. Në vendimin e Kuvendit nr.68, datë 20.2.2003 “Për mënyrën e trajtimit të deputetëve”, i ndryshuar:

1. Pikat V dhe VI shfuqizohen.

2. Në pikën VIII fjalët “dhe V”, si dhe fjalia “Pagesa e llogaritur sipas pikës VI jepet në të njëjtën mënyrë çdo tre muaj”, shfuqizohen.

III. Në ushtrim të mandatit, deputetëve të legjislaturës XVIII u rimbursohen shpenzimet financiare të karburantit për periudhën 7 shtator 2009 deri më 20 nëntor 2009. Masa e rimbursimit përcaktohet duke marrë në konsideratë një mesatare, sipas qarqeve ku janë zgjedhur.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare prej datës 20.11.2009.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

**MASA E PËRFITIMIT FINANCIAR MUJOR PËR SHËRBIMIN E TRANSPORTIT TË
DEPUTETËVE**

Nr.	Zonat	Nr.dept.sipas zonave	Vlera mujore/lekë	Lekë
				Gjithsej
1	Tirana	32	37,000	1,184,000
2	Durrësi	13	37,000	481,000
3	Lezhë	7	40,000	280,000
4	Elbasani	14	42,000	588,000
5	Dibra	6	57,000	342,000
6	Vlora	12	55,000	660,000
7	Shkodra	11	49,000	539,000
8	Fieri	16	45,000	720,000
9	Berati	8	45,000	360,000
10	Kukësi	4	56,000	224,000
11	Korça	12	53,000	636,000
12	Gjirokastra	5	57,000	285,000
	Totali	140		6 299 000

VENDIM
Nr.1103, datë 14.11.2009

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË
LUFTËS KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIQEVE DHE TERRORIZMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të veprimit të strategjisë ndërsektorale të luftës kundër krimit të organizuar, trafikeve dhe terrorizmit, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLANI I VEPRIMIT
PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË LUFTËS KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR,
TRAFIQEVE DHE TERRORIZMIT

Objektivat e strategjisë	Mënyrat e veprimit	Institucionet zbatuese	Afatet kohore	Kosto financiare dhe kush e mbulon
1. Ripunimi e azhurnimi i gjithë planeve te veprimit të hartuara deri në miratimin e kësaj strategjie, hartimi i planeve të veprimit të reja nga të gjitha institucionet që nuk kanë pasur të tilla deri tani dhe që marrin detyra sipas drejtimeve të krimit të organizuar dhe terrorizmit. Planet e veprimit të hartohen sipas fazave që përcakton kjo strategji.	1.1 Të ngrihet një grup pune ndërinstitucional i cili do të ketë si mision: a) Të bëjë vlerësimi dhe analizën e realizimit të detyrave të parashikuara në Strategjinë Antidrogë 2004-2010 dhe Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë. b) Të hartojë draftin dhe të propozojë ndryshimet e nevojshme për një strategji apo plan veprimi të ri.	1.1 K. Ministrave M.Brendshme M.Shëndetësisë M.Arsimit M.Bujqësisë M.Mjedisit Prokuroria SHISH	1.1 Maj 2010	151 937 5,096
	1.2 Hartimi i draftit të strategjisë ndërsektoriale për parandalimin dhe goditjen e krimit financiar dhe pastrimit të parave, si dhe hartimi i planit të veprimit për zbatimin e kësaj strategjie.	1.2 K. Ministrave M.Financave M.Brendshme M.Drejtësisë Prokuroria SHISH Banka e Shqipërisë	1.2 Tetor 2009	(donacion nga BE, projekti i binjakëzimit për luftën kundër pastrimit të parave me BKA, Gjermani).
2. Krijimi i strukturave sipas kërkesave apo të parashtruara në strategjitë e tjera, rishikimi i komiteteve, komisioneve, sekretarive apo çdo funksion tjetër i krijuar nga strategjitë sektoriale me qëllim zgjerimin e kompetencave apo funksionimin e tyre për të gjithë drejtmet e luftës kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.	2.1 Të ngrihet një grup pune ndërinstitucional i cili do të ketë si mision hartimin e një akti normativ për funksionimin e Komitetit Kombëtar të Bashkërendimit të Luftës Kundër Drogës, Sekretariatit dhe Qendrës Kombëtare të Grumbullimit të të dhënave për drogën. 2.2 Të ngrihet zyra e gjurmimit të aseteve kriminale pranë Drejtorisë kundër Krimit Financiar në Departamentin e Hetimit të Krimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.	2.1 K. Ministrave M.Brendshme M.Shëndetësisë M.Arsimit M.Bujqësisë M.Mjedisit Prokuroria SHISH 2.2 M.Brendshme	2.1 Dhjetor 2009 2.2 Qershor 2010	126

3. Hartimi dhe përqasja e legjislacionit sipas standardeve të BE, në lidhje me luftën kundër krimit të organizuar, trafikëve të paligjshme e terrorizmit, luftën kundër korrupsionit, pastrimit të parave, vënien në përdorim të sendeve e mallrave që rrjedhin nga një krim, si dhe akteve të tjera të funksionimit të strukturave që kanë përgjegjësi për këtë drejtim, bazuar në strategjitë e tjera si dhe në planet e veprimit.	3.1 Të ndiqen procedurat për ndryshimin e ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale” me qëllim ndryshimin e nenit 75/a “Kompetencat e gjykatës për krime të rënda” të Kodit të Procedurës Penale dhe përfshirjen në këtë nen të veprës penale të trafikimit të mjeteve motorike. 3.2 Do të bashkëpunohet me Ministrinë e Drejtësisë për hartimin e draftit për një ndryshim në Kodin e Procedurës Penale që në rastin e sekuestrimeve të sasirave të konsiderueshme me lëndë narkotike, do të lejonte shkatërrimin e pjesës më të madhe të tyre përpara përfundimit të procesit gjyqësor. 3.3 Hartimi i një ligji të plotë e sipas standardeve europiane për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë Është ngritur grupi i punës me pjesëmarrje të institucioneve të interesuara, organizmave ndërkombëtare dhe OJQ –ve a) Është hartuar drafti dhe është miratuar edhe në Këshillin e Ministrave. b) Jemi në fazën e miratimit të projektligjit nga Kuvendi	3.1 M.Brendshme M.Drejtësisë P.Përgjithshme 3.2 M.Brendshme M.Drejtësisë P.Përgjithshme 3.3 M.Brendshme Prokuroria Ministria e Drejtësisë	3.1 Dhjetor 2009 3.2 Dhjetor 2009 Në varësi të miratimit të ligjit nga Kuvendi	
4.Hartimin e gjithë akteve të nevojshme që do të thellojnë bashkëpunimin me strukturat homologe të vendeve të rajonit e me gjerë në luftën kundër krimit të organizuar ndërkufitar e formave të ndryshme të krimit të organizuar, korrupsionit apo terrorizmit	4.1Negocimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të reja dy dhe shumëpalëshe për luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikëve të paligjshme. 4.2. Ligjit” Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë“ është miratuar nga Kuvendi në datën 22.10.2008. Në zbatim të dispozitave të tij do të hartohen aktet nënligjore të përcaktuara në të, të cilat kanë si objekt edhe bashkëpunimin midis agjencive të ndryshme.	4.1 M.Brendshme M.Drejtësisë P.Përgjithshme 4.2. M.Brendshme Prokuroria Ministria e Drejtësisë Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë, etj	Në vazhdim	

	4.2.a. Aktet nënligjore janë:		30.03.2010	
	1.Vendimi i Këshillit të Ministrave, në lidhje me trajtimin dhe përfitimet të punonjësve të Drejtorisë së Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, në zbatim të nenit 5, paragrafi 3, i këtij ligji;		30.03.2010	
	2.Udhëzim i përbashkët i Ministrit të Brendshëm dhe Prokurorit të Përgjithshëm, në lidhje me:		30.03.2010	
	a)rregullat dhe kriteret e hollësishme, për çështjet e parashikuara në nenin 11, paragrafët 1,2 dhe 3, të këtij ligji;			
	b) rregullat e hollësishme për detyrat, përgjegjësitë, format dhe procedurat e bashkërendimit e të informimit, ndërmjet institucioneve, në zbatim të nenit 14 të këtij ligji;		30.03.2010	
	c) kriteret dhe procedurat për ruajtjen, administrimin dhe klasifikimin e informacionit për programin e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, në zbatim të nenit 15, paragrafi 1, të këtij ligji;		30.03.2010	
	ç) rregullat e hollësishme për rastet,procedurat dhe mënyrat e zbatimit të masave të posaçme dhe të përkohshme të mbrojtjes, në zbatim të neneve 16,17 e 18 të këtij ligji;		30.03.2010	
	3.Udhëzim i përbashkët i Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, në lidhje me:			
	a) administrimin e pasurive dhe fondeve të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë të Drejtorisë, dokumentimin e shpenzimeve dhe kontrollin e veprimtarisë financiare të drejtorisë, në zbatim të nenit 5, paragrafi 4, i këtij ligji;		30.03.2010	
	b) mënyrën e caktimit të ndihmës financiare dhe masën e saj, në zbatim të nenit 13, paragrafi 2, i këtij ligji;			

	4.Rregullore e brendshme e drejtorisë, në lidhje me: a) rregullat me karakter teknik dhe operativ për kushtet, metodikat dhe procedurat e verifikimit, të përgatitjes dhe zbatimit të programit të mbrojtjes, për mënyrat, format dhe mjetet e komunikimit, si dhe për administrimin e akteve dhe të informacionit që lidhet me veprimtarinë e vet, në zbatim të nenit 6 të këtij ligji; b) rregullat dhe kriteret e hollësishme për përmbajtjen, kuptimin, përshtatshmërinë, mënyrën dhe procedurat e caktimit dhe të shkallëzimit të masave që përbëjnë programin e mbrojtjes; c) rregullat e hollësishme për procedurat e shprehjes së vullnetit, bisedimit dhe nënshkrimit, për formën dhe përmbajtjen, si dhe për ndjekjen e zbatimit të kushteve të marrëveshjes së mbrojtjes, në zbatim të neneve 19 e 20 të këtij ligji; 5.Rregullore e brendshme e komisionit, në lidhje me rregullat e hollësishme për kriteret dhe procedurat e punës për thirrjen dhe pjesëmarrjen në mbledhjet e tij, mungesën dhe pamundësinë e caktimit dhe të kryerjes së kësaj detyre; 6.Udhëzimet e titullarëve të institucioneve në lidhje me depozitimin, mbajtjen dhe administrimin e informacionit për programin e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, në zbatim të nenit 15, paragrafi 2, të këtij ligji. 4.2.a Për hartimin e akteve të mësipërme do të ngrihen grupet e punës me përfaqësues nga agjenci të interesuara dhe përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare, si OPDAT, ICITAP, PAMEC, EURALIUS etj.		30.03.2010 30.03.2010 30.03.2010 30.03.2010 30.03.2010	
--	---	--	---	--

5. Krijimi i një sistemi të transmetimit të informacionit brenda strukturave të përfshira në luftën kundër krimit të organizuar. Përfundimi i sistemeve IT për transmetimin e analizën e informacionit që bën fjalë për vepra penale të krimit të organizuar e terrorizmit.	5.1 Do të përfundojë shtrirja e sistemit të analizës së informacionit kriminal-MEMEX në të gjitha Drejtoritë e Policisë në qarqe.	5.1 M.Brendshme	5.1 Dhjetor 2009	6,397
6.Minimizimi i përdorimit të drogave në vend, si dhe parandalimi i kultivimit të bimës kanabis sativa.	6.1 Do të vazhdojë goditja e grupeve kriminale që merren me trafikun e shpërndarjen e drogave. 6.2 Çdo vit të hartohet një plan veprimi i veçantë për luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike.	6.1 M.Brendshme 6.2 M.Brendshme	6.1 Në vazhdim 6.2 Çdo vit	171 412 254 480
7.Zgjerimi i aplikimit të teknikave të reja të investigimit, brenda suazës së përcaktuar në ligj, për të gjitha format e shfaqjes së krimit të organizuar.	7.1 Aplikimin në përputhje me ligjin procedural penal, të formave dhe metodave speciale të hetimit si (blerje e simuluar, apo dorëzim i kontrolluar), si një ndër mjetet më rezultative në luftë kundër këtij aktiviteti kriminal 7.2 Forcimi i kapaciteteve për përdorimin e metodave speciale të hetimit nëpërmjet përmirësimit të pajisjeve dhe trajnimeve të vazhdueshme të punonjësve në bashkëpunim dhe me partnerët ndërkombëtarë.	7.1 M.Brendshme 7.2 M.Brendshme	7.1 Çdo vit 7.2 Çdo vit	71 805
8.Identifikimi dhe analizimi i situatës së grupeve kriminale që kryejnë, apo dyshohet se kryejnë vepra penale të lidhura me krimin e organizuar e terrorizmin.	8.1Në bazë të urdhrit nr.996, datë 1.9.2009 “Për miratimin e udhëzuesit për vlerësimin e rrezikshmërisë së grupeve kriminale”, çdo vit brenda datës 1 tetor do të bëhet analizimi i situatës së grupeve kriminale dhe shkalla e rrezikshmërisë së tyre	8.1 M.Brendshme	8.1 Çdo vit	174 021
9.Realizimi i trajnimeve të vazhdueshme profesionale për specialistët që punojnë në strukturat që kryejnë veprimtari kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit. Shfrytëzimi i eksperiencave të vendeve të tjera në këtë drejtim.	9.1 Në bashkëpunim me departamentin e trajnimeve dhe partnerëve të tjerë të hartohen kurrikulat për trajnimin e vazhdueshëm të strukturave kundër krimit të organizuar, si dhe atyre të policimit në komunitet e dhunës në familje me qëllim ngritjen e kapaciteteve të punonjësve.	9.1 M.Brendshme	9.1 Çdo vit	69 342

	9.2 Trajnimi i të gjithë punonjësve të policisë antitrafik, dhunës në familje dhe policimit në komunitet në lidhje me Mekanizmin Kombëtar të Referimit, si dhe mënyrën e identifikimit të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit. 9.3 Të sigurohet që çdo punonjës policie antitrafik i njej të drejtat e viktimave, i respekton ato dhe mund ta informojë viktimën apo viktimën e mundshme për këto të drejta. 9.4 Kryerja e intervistimeve dhe marrja e deklarimeve nga ana e punonjësve të policisë gjithmonë në praninë e një punonjësi social apo të një psikologu. 9.5 Trajnimi në vazhdimësi i strukturave të hetimit të krimit financiar me teknikat e reja të hetimit të pastrimit të parave dhe gjurmimit, zbulimit e sekuestrimit të aseteve kriminale. 9.6.a. Në bashkëpunim me departamentin e trajnimeve dhe partnerëve të tjerë të hartohen kurrikulat për trajnimin e vazhdueshëm të strukturave kundër terrorizmit me qëllim ngritjen e kapaciteteve të punonjësve. 9.7 Realizimi i trajnimeve të vazhdueshme profesionale për specialistët që punojnë në strukturat e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë. Shfrytëzimi i eksperiencave të vendeve të tjera në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve. 9.7.a Në bashkëpunim me departamentin e trajnimeve dhe partnerët do të hartohen kurrikulat për trajnimin e vazhdueshëm të strukturave të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë me qëllim ngritjen e kapaciteteve të punonjësve. 9.7.b Bashkëpunimi në fushën e binjakëzimit me njësinë e mbrojtjes së dëshmitarëve të policisë austriake, sipas propozimit të bërë nga ana e tyre.	9.2 M.Brendshme 9.3 M.Brendshme 9.4 M.Brendshme Ministria e Brendshme Ministria e Brendshme	Mars 2010 Maj 2010	147 216 59 596
--	---	--	----------------------------------	------------------------------

10.Zhvillimi dhe thellimi i transparencës për komunitetin në lidhje me goditjen e krimit të organizuar.	10.1 Forcimi i bashkëpunimit midis të gjitha strukturave policore dhe shoqërisë civile me qëllim shkëmbimin e informacionit në lidhje me të gjitha format e krimit të organizuar. 10.2 Në bashkëpunim me punonjësit e policisë së policimit në komunitet të organizohen takime me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe parandalimin e të gjitha formave të krimit të organizuar dhe në veçanti e trafikimit të qenieve njerëzore. 10.3 Rritja dhe përmirësimi i bashkëpunimit midis policisë dhe Shërbimit Social Shtetëror. 10.4 Rritja e bashkëpunimi me institucionet kulturore, muzetë, institucionet arkeologjike, qendrën kombëtare të inventarizimit të pasurive kulturore, galeritë e arteve, entet e kultit etj, drejtuesit e tyre, me qëllim sensibilizimin për format e ruajtjes, inventarizimit dhe problemeve që janë konstatuar prej tyre etj.			126
11.Realizimi i një kontrolli të kufirit shtetëror, apo të të huajve duke iu përafuar standardeve të BE-së.	11.1 Bashkëpunimi në Policinë Kufitare dhe të migracionit, me qëllim marrjen e masave për parandalimin e trafikeve të të gjitha llojeve.	Policia e Shtetit		101 456
12.Realizimi i masave për të garantuar menaxhimin e integruar të kufirit	12.1Forcimi i bashkëpunimit me agjencitë kombëtare të zbatimit të ligjit. 12.2Forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar me agjencitë homologe të vendeve fqinje dhe më gjerë. 12.3Rritja e kapaciteteve të PKM dhe trajnimi i vazhdueshëm i tyre në drejtim të luftës kundër krimit ndërkufitar dhe krimit të organizuar 12.4Evidentimi i aktivitetit të kundërligjshëm nëpërmjet kufirit shtetëror dhe rritja e kapaciteteve për hetimin e veprave penale që ndjek PKM	Policia e shtetit/PKM SHDSH SHV SHF	Në vazhdimësi	Nuk ka kosto
13.Përsosja e teknikës në përdorim të PKM dhe rritja e kapaciteteve të saj	13.1Informatizimi i shërbimeve të PKM duke shtrirë linjat e komunikimit në SPKM 13.2Pajisja e PKK-ve me lexues të pasaportave biometrike.	Policia e Shtetit	Shkurt 2010	60 000 euro

14.Garantimi i një trajnimit bashkëkohor, cilësor dhe të vazhdueshëm të PKM	14.1Trajnimi i PKM për aktet që normojnë funksionimin e policive kufitare të vendeve të BE-së me qellin parapërgatitjen e saj që të jetë e profesionalizuar për vitet në vazhdim. 14.2Profilizimi i PKM sipas llojeve të shërbimit që kryejnë dhe forcimi i trajnimit në fushën e sigurisë së kufijve detarë	Policia e Shtetit MF/SHDSH MBUMK/SHV/SHF	Në vazhdimësi	Kosto administrative
1.Minimizimi i kërkesës për droga, përdorimit të tyre dhe pasojave shëndetësore e sociale nga abuzimi me to	a) Zbatimi i sistemit të licencimit (autorizimit) të veprimtarive që lidhen me lëndët narkotike dhe psikotrope dhe prekursorët e tyre; b) Zbatimi i procedurës së pajisjes së subjekteve me autorizim të posaçëm (leje) për importimin e LNP dhe prekursorëve të tyre; c) Informatizimi i të dhënave (sasia e importuar) lidhur me LNP dhe prekursorët e tyre; d) Shkëmbimi i informacionit të përcaktuar më sipër; e) me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit; f) Raportimi i të dhënave (import, prodhim, konsum, stoku për vitin e shkuar dhe kërkesa për vitin vijues); g) Pajisja me autorizim e operatorëve shëndetësore dhe strukturave shëndetësore trajtuese adiktive për përdorimin e substancave narkotike dhe psikotrope, si dhe prekursorëve, për qëllime mjekësore, si dhe për përshkrimin e recepturave po për këto qëllime; h) Farmacitë që do të furnizohen dhe ekzekutojnë recepturat me substanca narkotike, psikotrope dhe prekursorë, për qëllime mjekësore, do të autorizohen nga Ministria e Shëndetësisë. Subjektet e mësipërme shëndetësore (operatorët shëndetësorë, strukturat shëndetësore adiktive, farmacitë e autorizuar) do të mbikëqyren dhe kontrollohen vazhdimisht nga inspektorët dhe grupe të posaçme nga MSH.	Drejtoria Farmaceutike; Drejtoria e Shëndetit Publik (Sektori për çështjet e drogës dhe alkoolit)	Në vazhdimësi	50 milionë lekë
Parandalimi, identifikimi, trajtimi, marrja e masave për eliminimin e pasojave dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit/personave në rrezik trafikimi dhe reduktimi i rasteve	Në fushën sociale: Hartimi i rregulloreve, udhëzimeve dhe dokumenteve ndihmëse për zbatimin e standardeve të shërbimeve nga ofruesit publikë dhe privatë	MPÇSSHB, AP, ZKKA	2010	121.680 lekë

	Implementimi i standardeve të shërbimeve për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi dhe inspektimi i ofruesve të shërbimeve publike dhe private për zbatimin e standardeve të shërbimeve	MPÇSSHB AP,ZKKA dhe grupin e punës së MKR-së	2009-2013	28.200 milionë lekë (2009)
	Zbatimi i procedurave standarde operative (PSO-ve) për dhënien e ndihmës së individualizuar për integrim sipas skemave e modeleve të riintegrit	MPÇSSHB, AP, ZKKA, grupi MKR dhe partnerët	2009 e në vazhdim	78 000 lekë
	Vazhdimi i funksionimit të Qendrës Kombëtare të Pritjes për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore	MPÇSSHB SHSSH	2009- 2010	Për vitin 2009 28.200 milionë lekë Për vitin 2010 35 milionë lekë
.	Mbështetja e strehëzave ekzistuese të OJF-ve	MPÇSSHB, donatorët, strehëzat	2009-2013	Donatorët
	Rritja e nivelit profesional të personelit të shërbimeve sociale, përgjegjës për pritjen fillestare të viktimave të trafikimit përmes trajnimeve	MPÇSSHB në bashkëpunim me ZKKA,OJF dhe ON	Në vazhdim 2010	1 900 000 lekë
	Në fushën e punësimit/formimit profesional:Hapja e programeve të formimit profesional dhe programeve të tjera kualifikuese për të rinjtë rom, për të rinjtë VeT apo në rrezik trafikimi	MPÇSSHB ,SHKP (zyrat rajonale të punësimit) dhe partnerët	2009 e në vazhdim	5 milionë çdo vit
	Informimi i publikut dhe veçanërisht i grupeve në nevojë rreth ekzistencës së programeve të ndryshme të ndihmës, punësimit etj. dhe mbështetje shtesë për ta nëpërmjet institucioneve të MPÇSSHB.	MPÇSSHB, OJF-të dhe donatorët	Në vazhdim	3 milionë çdo vit
1.Lufta kundër fenomenit të përdorimit, abuzimit dhe shpërndarjes së drogës në mjediset shkollore	Nëpërmjet një arsimi cilësor dhe masiv synohet parandalimi i dukurive negative apo tendencat për to. Veprimtari: - Rritja e numrit të orëve mësimore me tematikë nga lufta kundër drogës, HIV, kriminalitetit, trafikimit etj. dhe efektivitetit të tyre; Shfrytëzimi efektiv i orëve të lira për biseda e veprimtari ekstrakurrikulare lidhur me rreziqet e drogës dhe kriminalitetit; Sigurimi në të gjitha shkollat : - i kabineteve të shërbimit psikologjik dhe pajisjen e tyre;	MASH, Instituti i Kurrikulës dhe Trajnimit Drejtoritë Arsimore Rajonale MASH	Vazhdimisht Vazhdimisht	Pa kosto 51 000 çdo vit MASH

	- i personelit me arsimin përkatës; grupit të mbështetjes së psikologut; Aktivitete të përbashkëta e të planifikuara me bordin e Shkollor, shoqatën e prindërve dhe OJF-të; - Anketime të përbashkëta mbi përdorimin e drogës; - Marrja e masave dhe kryerje aktiviteteve në drejtim të sensibilizimit të nxënësve, prindërve e komunitetit në përgjithësi. Organizimi i aktiviteteve sportive e kulturore për të mbajtur fëmijët larg veseve dhe ekspozimit ndaj fenomeneve kriminale. Aktivitet të përbashkëta me Policinë e Shtetit -Në shkollat me rrezikshmëri të lartë kryen veprimtari të përbashkëta sensibilizuese të planifikuara ose jo; Konsultime të vazhdueshme dhe organizimi i ruajtjes së përbashkët të mjediseve shkollore me (sinjalizim i menjëhershëm etj.) qëllim identifikimin e elementeve të dyshuar dhe neutralizimin e tyre.	MASH,drejtoritë arsimore rajonale, pushtetit vendor MASH Policia e Shtetit	Vazhdimisht Vazhdimisht	Pa kosto 500 çdo vit MASH
Ulja e braktisjes së shkollave deri në nivelin 0 në vitin 2013	Tërheqja e fëmijëve romë në arsim -Sensibilizimi i opinionit rom për regjistrimin e nxënësve në shkollë. -Ngritja pranë shkollave i kurseve për mësimin e gjuhës shqipe për nxënësit romë që vijnë për herë të parë në shkollë dhe ata që kanë mangësi të theksuara në mësimin e gjuhës shqipe. Hapja pranë shkollave të mesme profesionale, ku numri i nxënësve romë është i konsiderueshëm, i kurseve të trajnimit për gjuhën rome dhe kurse të tjera sipas natyrës të shkollës, traditës dhe prirjeve të tyre. Punë e diferencuar në shkolla për evidentimin e talenteve për të krijuar mundësitë e konkurrimit në shkollat e mesme artistike dhe profesionale Arsimimi i të gjithë fëmijëve parashkollorë. - Sensibilizimi i opinionit.	MASH Drejtoritë arsimore rajonale, pushtetit vendor MASH Drejtoritë arsimore rajonale, pushteti vendor	Vazhdimisht Vazhdimisht	51 000 çdo vit MASH 4000 çdo vit MASH 51 000 çdo vit MASH

	Emërimi i edukatoreve me përvojë, duke marrë dhe mendimin e komunitetit. Rikonstruksioni i kopshteve ose ngritja e objekteve të reja për të plotësuar kapacitetet. Arsimi bazë -Evidentimi i numrit të nxënësve që duhet të frekuentojnë shkollën. Zbatimi korrekt i ligjit për arsimin e detyrueshëm, kthimi në shkollë i fëmijëve që nuk e kanë përfunduar. Vendosja e sanksioneve ndaj familjeve që nuk çojnë fëmijët në shkollë; -Trajnimi i mësuesve që punojnë me nxënës që kanë braktisur shkollën dhe që kanë tendencë braktisjeje. Stimulimi me pagesë i këtyre mësuesve; -Arsim i specializuar për fëmijët e ngujuar; -Organizimi nga shkolla i aktiviteteve edukative jashtë mësimin me tematikë nga lufta kundër drogës, HIV, kriminalitetit, trafikimit etj; -Intensifikimi i punës me prindërit për ndërgjegjësimin e tyre për një qëndrim dhe vlerësim sa më pozitiv ndaj shkollës; -Rikonstruksioni ose ngritja e shkollave të reja, pajisja e shkollave me bazë materiale didaktike të nevojshme, rritja e aksesit në internet për krijimin e kushteve sa më të përshtatshme për ndjekjen e mësimin; - Transport falas për nxënësit e mësuesit me shkollën në distancë mbi 2 dhe 4 km nga vendbanimi. Rritja e frekuentimit të shkollave të mesme profesionale. Rritje me të paktën 10% të përqindjes të nxënësve në shkollat profesionale. -Rikthimi në shkollë i fëmijëve të trafikuar dhe në rrezik trafikimi dhe ofrimin e alternativave për formim profesional. -Rikonstruksioni/ngritja e shkollave të mesme profesionale e konvikteve të reja, modernizimi i tyre; -Pajisja me bursë e nxënësve jetimë, që kanë humbur kujdestarinë prindërore dhe me shkollën mbi 5 km larg;	MASH Drejtoritë arsimore rajonale, pushteti vendor	Vazhdimisht	500 çdo vit MASH 3500 çdo vit MASH 5000 çdo vit MASH 50 000 çdo vit 400 000 çdo vit MASH 700 000 çdo vit MASH + CARDS 52 000 çdo vit 150 000 çdo vit MASH Pa kosto shtesë
--	--	--	--------------------	---

	- Hartimi i kurrikulave në përputhje me kërkesat e tregut të punës;	MASH,DAR,ZA,pushteti vendor		
I. Pengimi i trafikimit të mjeteve motorike a) Siguria rrugore	1.Nëpërmjet kontrollit online në sistemin ASF2 të Interpolit, mospajisja me leje qarkullimi, certifikata pronësie dhe targa të mjeteve që konstatohen të trafikuar. Denoncimi i këtyre mjeteve në Policinë e Shtetit.	DPSHTR, Policia e Shtetit	Vazhdimisht	Nuk ka kosto financiare
II. Lufta kundër akteve terroriste a) Transporti ajror	1-Përcaktimi, koordinimi dhe zbatimi i masave përkatëse të sigurisë për parandalimin e akteve dhe ndërhyrjeve të jashtëligjshme në aviacionin civil. Organizimi i sigurisë në aviacionin civil në përputhje me standardet ndërkombëtare, hartimi dhe zbatimi i Programit Kombëtar të Sigurisë në Aviacionin Civil (PKSAC)	MPPTT, Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC)	2010-2011	3000 mijë lekë
b) Transporti rrugor	2.Vendosja e rregullave standarde të kontrollit duke garantuar kryerjen e veprimtarisë së transportit rrugor të mallrave të rrezikshme, sipas standardeve europiane Përgatitja e projektvendimit “Mbi procedurat uniforme në kontrollin e transportit rrugor të mallrave të rrezikshme, sipas direktivës 95/50/EC.	Ministria e Brendshme Operatori i Aeroportit (Tirana International Airport sh.p.k.)	2011-2012	Nuk ka kosto financiare
c) Transporti hekurudhor	3.Forcimi i mekanizmave për sigurinë dhe mbrojtjen e instalimeve kryesore, impianteve, objekteve të rëndësishme dhe mjetet e transportit publik (trena) për parandalimin e akteve terroriste. 4.Mbrojtja e sigurisë kombëtare dhe rendit publik nëpërmjet kontrollit të sigurisë në linjën hekurudhore, veprat e artit dhe në trenat e udhëtarëve. Vëzhgimi i vazhdueshëm 24 orësh i infrastrukturës hekurudhore dhe i mjeteve lëvizëse në zbatim të ligjit nr.9317, datë 18.11.2004 “Kodi hekurudhor i Republikës së Shqipërisë“.	MPPTT (DPSHTRR) Hekurudha shqiptare sh.a. Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor Policia e Shtetit	Vazhdimisht	Kosto financiare mbulohet nga shoqëria anonime Hekurudha shqiptare dhe Policia e Shtetit
d)Transporti detar	5.Ngritja e sistemeve elektronike të kontrollit të hyrjeve dhe daljeve të gjithë personave, që futen dhe dalin në territoret e porteve të Republikës së Shqipërisë.	Portet e Republikës së Shqipërisë	Deri në dhjetor 2011	3 milionë euro

	6.Ngritja e sistemeve automatike të kontrollit të trafikut të mjeteve detare, që futen dhe dalin në territoret e porteve të Republikës së Shqipërisë. 7.Pajisja e të gjitha forcave të sigurisë në porte me të gjitha mjetet e nevojshme për zbulimin dhe luftën kundër terrorizmit. Investim për ngritjen e sistemeve	Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve Forcat e sigurisë në porte	Deri në gusht 2011 Deri në dhjetor 2009	300 mijë euro
Hartimi i të gjitha akteve të nevojshme që do të thellojnë bashkëpunimin me struktura homologe të vendeve të rajonit e me gjerë në luftën kundër krimit të organizuar ndërkufitar e formave të ndryshme të krimit të organizuar, korrupsionit apo terrorizmit	Nënshkrimi i memorandumëve të bashkëpunimit (MoU) me struktura homologe ndërkombëtare (anëtare të grupit EGMONT)	DPPPP	Në vazhdimësi	3500
Thellimi i vazhdueshëm i bashkëpunimit midis institucioneve brenda vendit, si dhe me ato homologe të vendeve të tjera për luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit	Nënshkrimi dhe verifikimi i funksionimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me institucionet e tjera shtetërore dhe në vijimësi ato ndërkombëtare. Aksesimi nga ana e DPPPP në bazën e të dhënave dhe informacione të tjera dhe regjistra publik sipas përcaktimeve të ligjit 9917, datë 19.5.2008.	DPPPP DPSH PP DPT DPD ZQRPP SHISH DPSHTRR	Në vazhdimësi Mars 2010	14 200
Kryerjen e analizave të përbashkëta midis institucioneve të gjurmimit, hetimit e gjykimit lidhur me grupet kriminale të hetuara e gjykuara për krime të organizuara e terrorizëm, në funksion të marrjes së masave parandaluese	Përveç analizave rast pas rasti mes institucioneve të hetimit dhe gjurmimit të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit, mënyrë veprimi do të jetë edhe kryerja e një analize 3 mujore në funksion të këtij objekti, në të cilën përveç analizimit të arritjeve të periudhës pararendëse përcaktohen objektiva të qarta për periudhën në vijim.	DPPPP SHISH PP DPSH DPD DPT ZQRPP	Në vazhdim	200
Përfundimin e sistemeve të TI për transmetimin e analizave të informacionit që bën fjalë për vepra penale të krimit të organizuar dhe terrorizmit.	Implementimi i softit analitik të dizenuar për detektimin e rasteve me risk. Trajnimi i punonjësve përgjegjës të DPPPP për përdorimin me efikasitet të mundësive që ofron ky soft.	DPPPP	Dhjetor 2009 Në vazhdimësi	12 250

Realizimi i një sistemi të plotë të informimit për tentative të pastrimit të parave nga DPPP.	Mundësimi i raportimit online të RTV dhe RAD, nga bankat e nivelit të dytë, noterët dhe disa subjekteve të tjera sipas kërkesave të ligjit të ri 9917 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit”. Krijimi i aksesit për Policinë e Shtetit dhe prokurorinë në bazën e të dhënave që ka DPPP, në lidhje me transaksionet e dyshimta.	DPPPP PP,DPSH	Dhjetor 2009 Viti 2011	8400
Paraqitja e strukturave të shtetit shqiptar si partnerë të aftë profesionalisht të barabartë dhe të besueshëm për strukturat homologe të vendeve të tjera	Pjesëmarrja në projekte rajonale e më gjerë për parandalimin e pastrimit të parave/financimit të terrorizmit. Rritja e shkëmbimit të informacionit dhe feedback përkatës me struktura homologe të vendeve të tjera.	DPPPP	Në vazhdimësi	14 000
Realizimin e trajnimeve të vazhdueshme profesionale për punonjësit e DPPP	Seminare trajnimi me institucionet partnere brenda vendit. Seminare trajnimi jashtë vendit të organizuara nga institucione dhe organizata ndërkombëtare si FMN, Moneyval, Egmont Group.	DPPPP dhe institucionet partnere (ILDKP, BSH, PP, DPSH, DP D, DPT etj.)	Në vazhdimësi	15 000
Krijimi i strukturave me qëllim funksionimin e tyre për gjithë drejtimit e luftës kundër krimit të organizuar e terrorizimit	Ngritja e drejtorisë antitrafik, si strukturë e re, pjesë e Dept.operativ hetimore në DP e doganave.	Ministria e Financave DP e Doganave	2008	Burimet e veta, Lekë 1 000 000
Hartimi i akteve të nevojshme që do të thellojnë bashkëpunimin me struktura homologe të vendeve të rajonit në luftën kundër krimit të organizuar ndërkufitar	Përfaqësimi dhe pjesëmarrja aktive në grupin e punës së ekspertëve për hartimin e projekt konventës së SELEC (Qendra e zbatimi të ligjit për Europën Juglindore)	DP Doganave	Realizuar 2007,2008 deri në korrik 2009	Burime të veta, lekë 1 500 000, si dhe financime të SECI-t dhe TAIEX-it Euro-financime të njohura vetëm nga donatorët
Realizimin e trajnimeve të vazhdueshme profesionale për punonjësit e shërbimit doganor	Planifikimi dhe bashkëveprimi i strukturave të DP të doganave për realizimin e trajnimeve të personelit doganor	DP Doganave/DP Policisë Programi EXBS-Ambasada e SHBA	Realizuar 2008	Burime të veta, lekë 1.250.000, si dhe financime të programit EXBS/Ambasada e SHBA USD-financime të njohura vetëm nga donatori

V.9.Objektiva afatmesme (2009-2010) Realizimin e një kontrolli të kufirit shtetëror, duke iu përafuar standardeve të vendeve të BE-së	Ndjekja në vijimësi e planit të veprimit për zbatimin e strategjisë MIK	Ministria e Financave DP Doganave DP Policisë	Realizuar pjesërisht deri në shtator 2009/vijon	Burimet e veta, lekë 20 000 000
Thellimin e bashkëpunimit midis institucioneve brenda vendit, si dhe me ato homologe të vendeve të tjera për luftën kundër krimit të organizuar e terrorizmit	Bashkëhartimi dhe nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit me institucionet e tjera të zbatimit të ligjit dhe vijimi i bashkëpunimit me administratat doganore të vendeve kufitare, me qendër SECI, si dhe me projekte zhvillimi e organizma ndërkombëtarë	DP Doganave	Realizuar deri në shtator 2009/vijon	Burimet të veta lekë 25 000 000 Burime të institucioneve partnere Euro-financime të njohura vetëm nga inst. partnere
V.10 Objektiva afatgjata (2011 - 2013) Realizim i parandalimit të krimit të organizuar e trafikeve ilegale dhe minimizimi i veprave penale që lidhen me to, duke arritur në standardet e vendeve me të zhvilluara në këtë drejtim	Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional me strukturat e tjera të zbatimit të ligjit	Ministria e Financave/DP Doganore	Në vijimësi	Burimet e veta lekë 30 000 000 kontribute nga projektet e binjakëzimit që asistojnë strukturat e shqiptare të zbatimit të ligjit Euro-financime të njohura vetëm nga donatorët
Paraqitja e strukturave të shtetit shqiptar si partnerë të aftë profesionalisht të barabartë dhe të besueshëm për homologët e vendeve të tjera	Rritja e bashkëpunimit dhe kontributit për forcimin e qendrës SECI dhe shndërrimin e saj në organizatë ndërkombëtare	DP Doganave	Realizuar 2007, 2008 deri shtator 2009 vijon	Burime të veta lekë 35 000 000, si dhe financime të SECI-t dhe TAIEX-it euro-financime të njohura vetëm nga donatorët
Forcimi i kapaciteteve të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara.	1. Draftimi i ligjit të ri për organizimin dhe funksionimin e AAPSK. 2. Rritja e kapacitetit teknik të stafit të AAPSK nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme të specializuara.	Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Prokuroria e Përgjithshme OPDAT, EURALIUS, DKE. Ministria e Financave AAPSK, MB, OPDAT dhe DKE	Brenda vitit 2009 Në vazhdimësi	Nuk ka kosto buxhetore shtesë 15.000 lekë Nuk ka kosto buxhetore shtesë Për trajnimin e stafit do të përdoret fonde dhe ekspertiza e misionëve OPDAT dhe DKE

	3.Hartimi dhe miratimi i procedurave standarde të punës për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.	Ministria e Financave AAPSK, Ministria e Brendshme	Brenda gjashtë muajve pas miratimit të ligjit	Nuk ka kosto buxhetore shtesë.
Lufta kundër krimit të organizuar Lufta kundër drogës Lufta kundër trafikeve të tjera të paligjshme Parandalimi i pastrimit të parave Ruajtja e kufijve nga migracioni Lufta kundër akteve terroriste	Hartimi dhe përmirësimi i akteve të nevojshme ligjore Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9284, datë 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”. Themelimi i bashkëpunimit ndërmjet strukturave kompetente vendase dhe homologe të vendeve të rajonit e gjerë Projektligj “Për bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar në fushën penale” Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8677, datë 2.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, i ndryshuar Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”. Nënshkrimi i marrëveshjes me Eurojust	Ministria e Drejtësisë	Tetor 2009 Dhjetor 2009	Kosto administrative (burime njerëzore) Ka kosto Institucionet përgjegjëse për zbatim
	Nënshkrimi memorandumeve të tjera me vendet e BE-së, të rajonit e më gjerë. Inspektimi i vendimeve të dhëna kundër autorëve të krimit të organizuar, trafikeve, drogës, pastrimit të parave, migracionit të paligjshëm dhe akteve terroriste.	Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Prokuroria e Përgjithshme INTERPOL Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme Ministria e Jashtme, Prokuroria e përgjithshme	Në vazhdim Në vazhdim	Ka kosto institucionet përgjegjëse për zbatim Kosto administrative (burime njerëzore)

	Inspektimi periodik i organeve të sistemit gjyqësor (gjykata, prokurori)	Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë		
Lufta kundër korrupsionit	Implementimi i akteve ndërkombëtare të fushës së korrupsionit dhe, kryesisht, rekomandimet e GRECO-s, në sistemin e drejtësisë. Hetimi dhe dënimi i korrupsionit. Sigurimi i efektshmërisë së ndjekjes penale dhe rritjes së shpejtësisë së gjykimit. Rritja e integritetit dhe rezistencës ndaj korrupsionit në sistemin e drejtësisë. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.	Ministria e Drejtësisë	Brenda vitit 2009	Kosto administrative (burime njerëzore)
	Projektligji “Për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe organizimin e drejtësisë administrative”.		Brenda vitit 2009	Ka kosto USAID
	Projektligji “Për administratën gjyqësore”		Brenda vitit 2009	Ka kosto, Buxheti i Shtetit
	Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar”.		Brenda vitit 2009	Kosto administrative (burime njerëzore)
	Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.		Dhjetor 2009	Kosto administrative (burime njerëzore)
	Projektligji “Për faljen”.		Dhjetor 2009	Kosto administrative (burime njerëzore)
	Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare”.		Dhjetor 2009	Kosto administrative (burime njerëzore)
	Aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 10 031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”.		Brenda vitit 2009	Kosto administrative (burime njerëzore)
	Vënia në funksionim të sistemit CCMIS&ICMIS në gjykata (Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Civile dhe Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Penale), nëpërmjet të cilit synohet të arrihet: a) standardizimi i dosjes gjyqësore,	Ministria e Drejtësisë dhe gjykata	Brenda vitit 2009	Ka kosto Bashkimi European (270 mijë euro) Ministria e Drejtësisë

	b) rritja e aksesit dhe dalja në web të gjykatave dhe publikimit të vendimeve gjyqësore, c) gjenerim të statistikave të sakta dhe raporteve të performancës në çdo gjykatë, ç) si dhe rritja e transparencës dhe reduktimi i fenomeneve korruptive në zgjidhjen e çështjeve. Funksionimi i një arkive të veçantë që do të merret me arkivimin e dokumenteve në sektorin gjyqësor.		Brenda vitit 2009	Ka kosto USAID
Minimizimi i përdorimit të drogave në vende, si dhe parandalimi i kultivimit të bimës kanabis sativa	Forcimi i kontrollit në pikat e kalimit kufitar për importin e materialit mbjellës bimor të bimëve të dyshuara si narkotike	Ministria e Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit Ministria e Financave Policia e Shtetit	Në vazhdim	Ministria e Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (inspektoret e karantinës) 89 172 000 lekë Kosto administrative
	Për çdo rast të kultivimit të kerpit industrial me përmbajtje të THC nën 0,1% do të bëhet monitorimi i përbashkët nga Policia e Shtetit, Ministria e Bujqësisë dhe pushteti vendor dhe mostrimi për analizën e THC-së.	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit Ministria e Brendshme	Gjatë muajit korrik	
Informimi në kohë për indikacione mbi veprimtari terroriste, trafike apo rrjete të krimit të organizuar, që mund të kërcënojnë sigurinë kombëtare dhe atë të Forcave të Armatosura	Përmirësimi i teknikave të grumbullimit të informacionit për shkëmbimin në kohë të tij Grumbullim informacioni duke përdorur me efikasitet strukturat përkatëse të nivelit taktik dhe operacional Vlerësimi i rreziqeve dhe kërcënimeve të mundshme ndaj sigurisë fizike, sigurisë së personelit, sigurisë së informacionit të klasifikuar shtetëror dhe të NATO-s, si dhe sigurisë së operacioneve që kryejnë njësitë/repartet e Forcave të Armatosura Ndjekja e procesit të demontimit dhe asgjësimit të armatimit të municioneve të tepërta dhe të rrezikshme të Forcave të Armatosura, informimi për akte të mundshme terroriste apo përfshirje në trafike gjatë procesit	Shërbimi Informativ Ushtarak, Policia Ushtarake Drejtoria e Zbulimit Ushtarak, Policia Ushtarake Drejtoria e Zbulimit Shërbimi informativ Ushtarak, Policia Ushtarake Drejtoria e Zbulimit Shtabi i Përgjithshëm komanda e forcave, Shërbimi Informativ Ushtarak, Policia Ushtarake	E përhershme E përhershme E përhershme	Buxheti i MM 1 000 000 lekë Buxheti i MM 2 500 000 lekë Buxheti i MM nuk ka kosto

	Informim për dobësi të mundshme në sistemin e sigurisë fizike dhe industriale gjatë procesit të demontimit dhe asgjësimit të municioneve Zbatimi i procedurave për certifikimin e personelit civil dhe ushtarak të MM dhe FA që ka të drejtën për t'u njohur me informacionin e klasifikuar shtetëror dhe të NATO-s, si dhe për certifikimin e subjekteve juridike e fizike që veprojnë në cilësinë e kontraktorit apo nënkontraktorit me MM, FA, industrinë ushtarake etj.	Shërbimi informativ Ushtarak, Policia Ushtarake drejtorja e Zbulimit Shërbimi Informativ Ushtarak, Drejtorja e Zbulimit	E përhershme E përhershme	Buxheti i MM dhe mbështetje nga vendet anëtare të NATO-s 30.000 000 Euro Buxheti i MM 3 500 000 Buxheti i MM nuk ka kosto
2. Përfshirja e kërcënimeve dhe rreziqeve të përcaktuara sipas pikës 1 në prioritetet të veprimtarisë informative të SHIU-t	Përcaktimi i kërkesave për grumbullim informacioni dhe përfshirja e kërcënimeve dhe rreziqeve të përcaktuara në pikën 1 në kërkesat prioritare për inteligjencë të SHIU-t, miratimi i tyre nga Ministri i Mbrojtjes.	SHIU	Brenda vitit 2009	Buxheti MM nuk ka kosto
3. Shkëmbimi i informacionit sipas marrëveshjeve përkatëse me strukturat e tjera brenda e jashtë vendit të përfshira në luftën kundër terrorizmit e krimit të organizuar.	Përgatitja dhe miratimi i një plani bashkëpunimi ndërmjet Shërbimit Informativ Ushtarak, Drejtorisë së Zbulimit, Qendrës së Zbulimit Radioteknik dhe Policisë Ushtarake Përgatitja dhe miratimi i një memorandumit bashkëpunimi ndërinstitutional me strukturat e SHISH, Policisë së Shtetit etj. Bashkëpunim me strukturat respektive të NATO-s Bashkëpunim me struktura respektive të shërbimeve të vendeve aleate e partnere. Kryerja e operacioneve të përbashkëta me partnerë strategjikë. Monitorimi i pandërprerë i hapësirës detare dhe shkëmbimi i informacionit me institucionet e tjera që kanë interesa në det	SHIU, Drejtorja e Zbulimit, Policia Ushtarake, Qendra e Zbulimit Radioteknik SHIU në bashkëpunimin me SHISH, Policinë e Shtetit etj. Shërbimi informativ Ushtarak, Shtabi i Përgjithshëm SHIU, Drejtorja e Zbulimit SHIU Komanda e Forcave Ajrore	Deri në janar 2010 Brenda 2009 E përhershme E përhershme Sipas planeve të përbashkëta E përhershme	Buxheti i MM nuk ka kosto Institucionet bashkëpunuese nuk ka kosto Buxheti i MM nuk ka kosto Buxheti i MM nuk ka kosto Buxheti i MM nuk ka kosto Buxheti i MM

	(Kapitenerinë e Porteve, Policinë Kufitare, Inspektoratet e Peshkimit, Autoritetet Doganore, Antikontrabanda Detare etj.). Zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja Rrjeti Ndërrajonal Detar “Trans Regional Maritime Network” Shkëmbimi i informacionit me Qendrën Operacionale në Romë sipas Marrëveshjes V-RMTC Vënia në funksionimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Operacioneve Detare	Komanda e Forca Detare Komanda e Forcave Detare Sipas VKM Ka dalë VKM nr.954 datë 3.9.2009 dhe nga ana e FD ka filluar funksionimi i QNOD prej 2 vjetësh, kurse institucionet e tjera që kanë interesa në det nuk kanë krijuar tavolinat e punës në këtë qendër me koordinatorët përkatës sipas VKM	Sipas marrëveshjes Detyrë e përhershme Brenda vitit 2009	40.210.600 lekë (mirëmbajtje pajisje, dieta dhe shërbime)FD Buxheti i MN Nuk ka kosto Buxheti i MM 130.000 lekë (Mirëmbajtje pajisje, bojë, kancelari FD) Buxheti i MM nuk ka kosto Buxheti i institucioneve të tjera i papërcaktuar
4. Krijimi i një strukture të integruar të SHIU-t, Zbulimit Ushtarak dhe Qendrës së Zbulimit Radioteknik	Përgatitja e draftprojektit të strukturës së integruar dhe miratimi nga Ministri i Mbrojtjes. Vendosja e të gjitha aseteve grumbulluese të informacionit nën një strukturë të vetme. Përmirësime ligjore dhe nënligjore. Trajnim personeli nëpërmjet kurseve për luftën kundër terrorizmit, trafikeve dhe krimit të organizuar.	SHIU, drejtoria e zbulimit, Qendra e Zbulimit Radioteknik.	Brenda 6-mujorit i te vitit 2010	Buxheti i MM nuk ka kosto
5. Modernizimi i sistemit të marrjes dhe shkëmbimit të informacionit	Vendosja e linjave të komunikimit të rrjeteve të klasifikuara e të paklasifikuara për shkëmbimin e informacionit në strukturën e re të integruar te inteligjencës ushtarake.	SHIU, Drejtoria e Zbulimit, Qendra e Zbulimit Radioteknik	Brenda 2010	Buxheti i MM nuk ka kosto

	Instalimi përfundimtar i sistemit të shkëmbimit të sigurt të informacionit të klasifikuar (BICES) me NATO-n.	SHIU, Drejtoria e Zbulimit	Janar 2010	Buxheti i MM 26 000 000 lekë
6. Krijimi i kapaciteteve dhe aseteve ushtarak për përdorim të integruar me institucione të tjera	Krijimi i qendrave të inteligjencës taktike dhe operacionale për mbështetjen me informacion për sigurinë e forcave tona në zonat e përgjegjësisë gjatë kryerjes së misioneve jashtë vendit.	SHIU, Drejtoria e Zbulimit	E përhershme	Buxheti i MM 10 000 000 lekë
	Kryerja e studimit dhe dhënia e rekomandimeve për vendimmarrje të autoriteteve përkatëse për përballimin e rasteve të mundshme të përdorimit të avionëve civilë për qëllime terroriste. (RENEGADE)	Shtabi i Përgjithshëm, (Komanda e Forcave Ajrore) në bashkëpunim me Agjencinë Nacionale të Trafikut Ajror.	Brenda 6 muajve të parë të vitit 2010	Buxheti MM 2 00 000 lekë
	Përmirësimi i planeve operacionale për mbrojtjen dhe ruajtjen e infrastrukturës, pasurisë ushtarake dhe jetës së personelit në garnizonet ushtarake.	Shtabi i përgjithshëm, komandat e forcave	E përhershme	Buxheti MM 35 000 000 lekë
	Marrja e masave të plota për sigurinë e informacionit klasifikuar kombëtar dhe të NATO-s	Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm, Komandat e Forcave	E përhershme	Buxheti MM 390 000 lekë
	Pajisja e grupeve të kontrollit të anijeve (Bording) me mjetet e nevojshme.	Komanda e Forcave Detare	Brenda viti 2009	Donacion i palës amerikane (65 000 dollarë)
	Pajisja me 5 anije të reja me kapacitete për luftë kundër terrorizmit.	Komanda e Forcave Detare	2010-2011	Donacion i palës amerikane (2 500 000 dollarë)
	Zhvillimi i stërvitjes dhe operacioneve të përbashkëta të anijeve të Rojës Bregdetare me institucionet e tjera (Forcat Ajrore, Policia Kufitare, Kapiteneria e Porteve, Antikontrabanda Detare etj.) Pjesëmarrje në seminare, workshop dhe konferenca të organizuara rang kombëtar dhe ndërkombëtar për luftën kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar.	Forcat detare Forcat ajrore Policia kufitare	E përhershme	Buxheti MM 57 000 000 lekë
	Marrja në dorëzim dhe vënia në përdorim e sisternit të vëzhgimit të hapësirës detare	Forcat e Armatosura, SHIU	E përhershme	Buxheti i MM 1 110 000 lekë

	Përpunimi i planeve operacionale dhe stërvitore për të siguruar mbështetjen e nevojshme të strukturave të tjera shtetërore në luftën kundër terrorizmit	Komanda e Forcave Detare Shtabi i Përgjithshëm dhe SHIU, në bashkëpunim me strukturat e Ministrisë së Brendshme	Brenda vitit 2009 Gjatë vitit 2009	Buxheti i MM 40 210 600 (Mirëmbajtje, pajisje dhe shërbime për çdo vit) Buxheti i MM 15 000 000 lekë
7. Bashkëpunimi stërvitor dhe operacional me organizmat ndërkombëtarë për luftën kundër terrorizmit	Zhvillimi i stërvitjeve dhe operacioneve të përbashkëta rajonale dhe bilaterale me vendet partnere (iniciativa ADRION) Pjesëmarrja në operacionin e NATO-s kundër terrorizmit detar "Active Endeavour". Shkëmbimi i informacionit me Komandën e Komponentit Detar të Komandës së Forcave të Bashkuara të NATO-s Napoli. Vijimi i trajnimeve të personelit të Forcave të Armatosura, në bashkëpunim me vendet aleate e partnerë për pjesëmarrje të përbashkëta në operacionet kundër terrorizmit brenda e jashtë vendit.	Komanda e Forcave Detare Komanda e Forcave Detare Shtabi i përgjithshëm, SHIU	E përhershme	Buxheti i MM 42.000.000 lekë Buxheti i MM 215 000 lekë Buxheti i MM 25 000 euro
A. Minimizimi i trafikut të qenieve njerëzore e trafikeve të tjera	1. Përfaqësitë e vendeve me emigracion të konsiderueshëm, si Greqia, Italia dhe SHBA janë pajisur me personelin e nevojshëm konsullor. Do të vazhdohet në këtë drejtim edhe me përfaqësi të tjera. 2. Të sigurohet këshillim, materiale informuese, këshilla, si dhe ndihmë konkrete për shqiptarët jashtë shtetit, nëpërmjet zyrave konsullore shqiptare jashtë vendit. MPJ dhe përfaqësitë kanë faqen e internetit ku jepet informacion për shtetasit shqiptarë dhe të huaj, lidhur me shërbimet konsullore që ofrohen. 3. Për këtë periudhë janë planifikuar trajnime të konsujve për çështje të trafikimit në mënyrë që ata të jenë në gjendje të evidentojnë rastet në rrezik dhe të japin informacion pa shkelur të drejtat e njeriut, apo të tërheqin vizat e tyre për dyshim trafikimi. Jepen vazhdimisht udhëzime përfaqësive	Ministria e Punëve të Jashtme	2009-2010 2010	MPJ 2. Pa kosto 3.1 milion lekë (PBA) 4.1 milion lekë (PBA)

B. Fuqizimi i bashkëpunimit me qytetarët dhe lufta kundër korrupsionit.	sipas rasteve që paraqiten. 4. Thjeshtimi dhe standardizimi i procedurave të shërbimeve që ofron MPJ. 5. Drejtoria Konsullore po punon për hartimin e manualit konsullor, i cili do të jetë një tërësi normash ligjore dhe nënligjore shoqëruar me materiale ilustruese për të shërbyer si bazë në punën e përditshme konsullore nëpër ambasada. 6. Në sektorin e marrëdhënieve me publikun në Drejtorinë Konsullore do të vendoset një linjë direkte telefoni. 7. Koordinimi i punës me Drejtorinë e Auditit të MPJ për të audituar punën e sektorëve konsullorë të përfaqësive tona jashtë shtetit.		2010	5. Pa kosto 6.15 mijë lekë PBA
C. Forcimi i kontrollit të kufijve nëpërmjet implementimit të strategjisë së menaxhimit të integruar të kufirit	1. Bashkëpunimi me MB në fushën e vizave, azilit dhe migracionit. a) Ngritja e qendrës së mbyllur për emigrantët e parregullt. Negocimi i marrëveshjeve të riparimit, si dhe zbatimi i tyre	Ministria e Punëve të Jashtme në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme	2009-2010	Pa kosto për MPJ
D.Bashkëpunimi i institucioneve shqiptare me homologët e huaj dhe organizatat ndërkombëtare	1. MPJ shfrytëzon të gjitha rrugët e komunikimit me përfaqësitë e huaja diplomatike dhe konsullore a) Vendosja e kontakteve me partnerë të huaj që trajtojnë çështje të trafikimit dhe bashkëpunimi me ta. b) Kontributi në marrëveshje të bashkëpunimit dhe i akteve të tjera ndërkombëtare në luftën kundër trafikëve të paligjshme, krimit të organizuar dhe terrorizmit.	Ministria e Punëve të Jashtme në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme.	Në vazhdim	Pa kosto
Hartimi i ligjit për procedurat tatimore dhe përfshirja në të e njësisë së hetimit tatimor	Ligji nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimet përkatëse që rregullojnë këtë ligj.	Ministria e Financës DPT	2008	DPT USAID
Krijimi i strukturave të Drejtorisë së Hetimit Tatimor për funksionimin dhe drejtimin e luftës kundër krimit tatimor	Ngritja e njësisë së hetimit tatimor në qendër dhe në bazë.	DPT	2008	3 220 000 lekë
Hartimi i memorandumeve të mirëkuptimit me institucione analoge për të luftuar krimin financiar	Memorandume mirëkuptimi me ILDKP, ZSHDA, KKRT, DPPP, Autoriteti i Konkurrencës etj.	DPT institucionet përkatëse	2008	DPT institucione të tjera

Organizimi i trajnimeve për punonjësit e njësisë së hetimit në kuadër të luftës kundër krimit tatimor	Planifikimi i organizimit të skemës së temave të trajnimit për punonjësit e njësisë së hetimit tatimor.	USAID Drejtoria e Trajnimeve, DPT, IPA, EUROPOL SIDA Pala Gjermane etj.	2008 e në vazhdim	USAID DPT IPA, SIDA Europol.
Hartimi i akteve të nevojshme për funksionimin e strukturave të Drejtorisë së Hetimit Tatimor	Hartimi i VKM nr.400, datë 22.4.2009 që përcakton detyrat dhe funksionimin e Dr. Hetimit Tatimor Dërgimi për miratim në KM i draftprojekt vendimit “Për caktimin e rregullave dhe kritereve për shpërblimin/pagesën e burimeve njerëzore të informacionit që kanë marrëveshje të fshehtë me strukturën e hetimit tatimor Hartimi i manualit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, për përcaktimin e detyrave dhe objektivave të kësaj njësie. Ngritja e një zyre dhe pajisja me linjë telefonike pa pagesë për denoncime nga publiku të evazionit tatimor dhe veprimeve korruptive.	Drejtoria e Hetimit Tatimor, DPT Drejtoria e Hetimit Tatimor, DPT USAID Drejtoria e Hetimit Tatimor, DPT USAID Drejtoria e Hetimit Tatimor, DPT	2009 2009 2009 2009	200 000 lekë 400 000 lekë USAID 1 000 000 lekë USAID burimet e veta 200 000 lekë
Evidentimi dhe dokumentimi i rasteve të hetimit të krimit tatimor	Krijimi i një baze të dhënash për raste të hetimit tatimor dhe shkëmbim bashkëpunimi mes institucioneve	Drejtoria e Hetimit Tatimor Institucionet përfituese	2009-2010	330 000 lekë
Ndërgjegjësimi i publikut të gjerë për rëndësinë e luftës kundër krimit financiar	Publikimi i lajmeve të fundit në media hartimi i masave konkrete për njohjen e publikut me zhvillimet ligjore në fushën e hetimit tatimor	DPT	2009-2010	USAID 2 400 000 lekë DPT 300 000 lekë
Rritja e bashkëpunimit mes institucioneve tona dhe ato ndërkombëtare	Nënshkrimi i protokolleve të bashkëpunimit ndërinstitutional dhe ndërkombëtar	DPT	2009-2010	10 000 000 lekë
Ngushtimi i boshllëkut tatimor nëpërmjet luftës së mashtrimit tatimor dhe evazionit fiskal	Rritja e bashkëpunimit me Prokurinë e Shtetit, Drejtorinë e Policisë së Shtetit DPD, ILDKP etj.	Drejtoria e Hetimit Tatimor, DPT Institucione të tjera	2009-2013	Burimet e veta
Forcimi i kapaciteteve parandaluese në luftën kundër mashtrimit tatimor dhe evazionit fiskal	Rritja e bashkëpunimit me institucionet e tjera dhe forcimi i kapaciteteve parandaluese të evazionit fiskal	Drejtoria e Hetimit Tatimor DPT Institucione të tjera	Realizuar 2009 e në vazhdim	Burimet e veta
Hartimi dhe përqasja e legjislacionit sipas standardeve të BE-së në lidhje me luftën kundër krimit të organizuar, trafikëve të paligjshme e terrorizmit,	Identifikimi i vazhdueshëm i problemeve ligjore gjatë aktivitetit hetimor me qëllim dhënien e propozimeve konkrete për të përmirësuar legjislacionin në fushën konkrete.	Sistemi i prokurorisë	Në vazhdimësi	3 milionë lekë

luftën kundër korrupsionit, si dhe akteve të tjera të funksionimit të strukturave që kanë përgjegjësi për këtë drejtim, bazuar në strategjitë e tjera, si dhe planet e veprimit.				
Hartimi i të gjitha akteve të nevojshme që do të thellojnë bashkëpunimin me struktura homologe të vendeve të rajonit e më gjerë në luftën kundër krimit të organizuar ndërkufitar e formave të ndryshme të krimit të organizuar, korrupsionit apo terrorizmit.	Rritja e bashkëpunimit të agjencive të zbatimit të ligjit duke rritur shkëmbimin e informacionit dhe numrin e rasteve të hetimeve paralele në më shumë se dy vende duke vënë prioritetet me vendet në të cilat është shtrirë më shumë krimi i organizuar shqiptar.	Prokuroria e Përgjithshme	Në vazhdimësi	14 milionë lekë
Krijimi i një sistemi të informacionit brenda strukturave të përfshira në luftën kundër krimit të organizuar	Fillimi i hartimit të një projekti për krijimin e një sistemi të dhënash mbi informacionet e rrjedhura nga hetimi i të gjitha rasteve që lidhen me veprat penale, objekt i kësaj strategjie.	Sistemi i prokurorisë	2010-2013	240 milionë lekë
Përfundimi i sistemeve të IT që bënë fjalë për transmetimin e analizën e informacionit që bënë fjalë për vepra penale të krimit të organizuar e terrorizmit.	Zbatimi i projektit të menaxhimit të rasteve.	Sistemi i prokurorisë	2010-2013	2.5 milionë Mbështetur nga Komisioni Europian.
Zgjerimi i aplikimit të teknikave të reja të investigimit brenda suazës së përcaktuar në ligj për gjithë format e shfaqjes së krimit të organizuar	Rritja e efikasitetit në hetim nëpërmjet përdorimit më të gjerë të metodave speciale të hetimit. Trajnime të vazhdueshme të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore mbi krimin e organizuar, trafikëve e terrorizmit. Angazhimi i një numri sa më të gjerë personash në hetimin e rasteve konkrete.	Sistemi i prokurorisë	Në vazhdimësi	42 milionë lekë 10 milionë lekë 180 milionë lekë
Thellimi i vazhdueshëm i bashkëpunimit midis institucioneve brenda vendit, si dhe me ato homologe të vendeve të tjera për luftën kundër krimit të organizuar e terrorizmit.	Vendosja e pikave të përhershme të kontaktit me institucionet brenda vendit, si dhe me ato homologe të vendeve të tjera për luftën kundër krimit të organizuar e terrorizmit.	Prokuroria e Përgjithshme dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit.	Në vazhdimësi	20 milionë lekë

Krijimi i strukturave sipas kërkesave apo të parashikuara në strategjitë e tjera, rishikimi i komiteteve, komisioneve, sekretarive apo çdo funksion tjetër i krijuar nga strategjitë sektoriale me qëllim zgjerimin e kompetencave apo funksionimin e tyre për gjithë drejtimet e luftës kundër krimit të organizuar e terrorizmit	Konsolidimi i njësive taks force të luftës kundër korrupsionit të krijuara pranë prokurorive në shtatë rrethe të vendit.	Sistemi i prokurorisë	Në vazhdimësi	280 milionë lekë
--	--	-----------------------	---------------	------------------

Shenim. Plani i veprimit i përgatitur nga SHISH do të jetë pjesë e këtij plani veprimi, por për shkak të karakterit të klasifikuar nuk bëhet publik

PLANI I VEPRIMIT I MINISTRISË SË DREJTËSISË
STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE TË LUFTËS KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIQEVE DHE TERRORIZMIT

Objektivat e strategjisë	Mënyrat e veprimit	Masat e planifikuara	Institucionet përgjegjëse	Afatet kohore	Kosto financiare* & subjekti që e mbulon	Komente
Lufta kundër krimit të organizuar Lufta kundër drogës Lufta kundër trafikeve të tjera të paligjshme	Hartimi dhe përmirësimi i akteve të nevojshme ligjore.	Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9284, datë 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”.	Ministria e Drejtësisë	Tetor 2009	Kosto administrative (burime njerëzore)	Është miratuar në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të zhvilluar më datë 21 tetor 2009.
Parandalimi i pastrimit të parave Ruajtja e kufijve nga migracioni	Thellimi i bashkëpunimit ndërmjet strukturave kompetente vendase dhe homologe të vendeve të rajonit më gjerë	Projektligji “Për bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar në fushën penale”	Ministria e Drejtësisë	Tetor 2009	Kosto administrative (burime njerëzore)	Është miratuar në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të zhvilluar më datë 21 tetor 2009.
Lufta kundër akteve terroriste		Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8677, datë 2.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, i ndryshuar		Dhjetor 2009	Kosto administrative (burime njerëzore)	Kanë filluar procedurat për rikompozimin e grupit të punës që do të hartojë ndryshimet.
		Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.	Ministria e Drejtësisë	Dhjetor 2009	Kosto administrative (burime njerëzore)	Përputhja me risitë që do të sjellin ndryshimet në ligjin për Policinë Gjyqësore.
		Nënshkrimi i marrëveshjes me Eurojust.	Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Prokuroria e Përgjithshme, INTERPOL	Dhjetor 2009	Ka kosto Institucionet përgjegjëse për zbatim	Janë vendosur pikat e kontaktit dhe pritët fillimi i procesit të negociimit për hartimin e kësaj marrëveshjeje.

		Nënshkrimi i memorandumeve të tjera me vendet e BE-së, të rajonit më gjerë	Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Jashtme, Prokuroria e Përgjithshme	Në vazhdim	Ka kosto Institucionet përgjegjëse për zbatim	Nxitja e bashkëpunimit dhe luftës së përbashkët kundër krimit të organizuar, trafikeve, drogës, pastrimit të parave, migracionit të paligjshëm dhe akteve terroriste.
	Inspektimi i vendimeve të dhëna kundër autorëve të krimit të organizuar, trafikeve, drogës, pastrimit të parave, migracionit të paligjshëm dhe akteve terroriste.	Inspektimi periodik i organeve të sistemit gjyqësor (gjykata, prokurori)	Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë	Në vazhdim	Kosto administrative (burime njerëzore)	Inspektimi i dosjeve dhe vendimeve të dhëna mbi çështjet që kanë objekt akuze/gjykimi rastet e krimit të organizuar, trafikeve, drogës, pastrimit të parave, migracionit të paligjshëm dhe akteve terroriste
Lufta kundër korrupsionit	Implementimi i akteve ndërkombëtare të fushës së korrupsionit dhe, kryesisht rekomandimet e GRECO-s, në sistemin e drejtësisë	Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.	Ministria e Drejtësisë	Brenda vitit 2009	Kosto administrative (burime njerëzore)	Pritet rivotimi nga Kuvendi i projektligjit, i cili parashikon shtimin e kreut të ri “Përgjegjësia nga veprimet korruptive”, në lidhje me shpërblimin e dëmit të shkaktuar
	Hetimi dhe dënimi i korrupsionit	Projektligji “Për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe organizimin e drejtësisë administrative”	Ministria e Drejtësisë	Brenda vitit 2009	Ka kosto USAID	Pritet miratimi i projektligjit nga Kuvendi dhe fillimi i hartimit të akteve nënligjore për zbatimin e tij.
	Sigurimi i efektshmërisë së ndjekjes penale dhe rritjes së shpejtësisë së gjykimit	Projektligji “Për administratën gjyqësore”.	Ministria e Drejtësisë	Brenda vitit 2009	Ka kosto Buxheti i Shtetit	Pritet përfundimi i shqyrtimit të projektligjit nga

	Rritja e integritetit dhe rezidencës ndaj korrupsionit në sistemin e drejtësisë.					komisionet parlamentare fillimi i hartimit të akteve nënligjore për zbatimin e tij.
		Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar.	Ministria e Drejtësisë	Brenda vitit 2009	Kosto administrative (burime njerëzore)	Pritet fillimi i shqyrtimit të projektligjit në komisionet parlamentare
		Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.	Ministria e Drejtësisë	Dhjetor 2009	Kosto administrative (burime njerëzore)	Kanë filluar procedurat për rikompozimin e grupit të punës që do të hartojë ndryshimet
		Projektligji “Për faljen”	Ministria e Drejtësisë	Dhjetor 2009	Kosto administrative (burime njerëzore)	Pritet të dërgohet për mendim pranë institucioneve të interesuara
		Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e konferencës gjyqësore kombëtare”	Ministria e Drejtësisë	Dhjetor 2009	Kosto administrative (burime njerëzore)	Priten sugjerimet e institucioneve pranë të cilave është dërguar për mendim
		Aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr.10031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”	Ministria e Drejtësisë	Brenda vitit 2009	Kosto administrative (burime njerëzore)	Ky objektiv është realizuar
		Vënia në funksionim të sistemit CCMIS&ICMIS në gjykata (Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Civile dhe Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Penale), nëpërmjet të cilit synohet të arrihet: a)Standardizimi i dosjes gjyqësore	Ministria e Drejtësisë dhe gjykatat.	Brenda vitit 2009	Ka kosto Bashkimi European (270 mijë euro) Ministria e Drejtësisë	Nga grupi i ekspertëve i ngritur për vënien në funksionim të këtij sistemi u konstatuan një sërë problemesh, të cilat nuk mundësonin arritjen e qëllimit të instalimit të tij.

		b) Rritja e aksesit dhe dalja në web të gjykatave dhe publikimit të vendimeve gjyqësore c) Gjenerim të statistikave të sakta dhe raporteve të performancës në çdo gjykatë.				Ky projekt i është kthyer firmës përgjegjëse DATECH, për rregullimin dhe sistemimin e problemeve të konstatuara.
		Funksionimi i një arkive të veçantë që do të merret me arkivimin e dokumenteve në sektorin gjyqësor.	Ministria e Drejtësisë dhe gjykatat	Brenda vitit 2009	Ka kosto USAID	Drejt përfundimit.

VENDIM
Nr.1151, datë 25.11.2009

PËR KRIJIMIN DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË VEÇANTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në njësitë e qeverisjes së përgjithshme krijohet fondi i veçantë, në masën 5 për qind të fondit të planifikuar për pagat.

2. Ky fond përdoret nga drejtuesit e njësive të qeverisjes së përgjithshme për shpërblimin e punonjësve, për rezultate të mira në punë, për dhënie ndihmash të menjëhershme, në raste fatkeqësish, sëmundjesh që kërkojnë ndërhyrje shëndetësore jashtë vendit, për veprimtari social-kulturore, si dhe për rastet e daljes në pension pleqërie.

3. Shpërblimi për rezultate të mira në punë gjatë vitit, për çdo punonjës, nuk duhet të jetë më shumë se 1 (një) pagë mujore në vit. Përgjithimisht për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, masa e shpërblimit nuk duhet të jetë më shumë se 2 (dy) paga mujore në vit.

4. Në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat janë në fushën e veprimit të ligjit të shërbimit civil, shpërblimi jepet në bazë të rezultateve individuale në punë, sipas parimeve dhe procedurës së përcaktuar në legjislacionin për shërbimin civil. Për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve kriteret e shpërblimit me mbi një pagë përcaktohen sipas udhëzimit përkatës të Ministrit të Financave dhe të ministrit të Brendshëm.

5. Shpërblimi për rezultate të mira në punë të përballohet nga fondi i veçantë edhe në rastet kur, sipas ligjeve të veçanta, lindin të drejta specifike të shpërblimit të punonjësve. Ky rregull nuk zbatohet vetëm kur në ligj janë parashikuar burime të tjera specifike, të ndryshme nga fondi i veçantë i pagave. Në këtë rast, kriteret dhe rregullat e përfitimit të shpërblimeve përcaktohen me udhëzime përkatëse.

6. Shpërblimi në fund të vitit i jepet çdo punonjësi të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, pavarësisht shpërblimit sipas pikës 3 të këtij vendimi, dhe përballohet nga fondi i veçantë.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për çdo institucion.

8. Ngarkohet Ministria e Financave për nxjerrjen e udhëzimit përkatës.

9. Vendimi nr.369, datë 13.6.2007 i Këshillit të Ministrave “Për fondin e veçantë në institucionet buxhetore”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori). Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 14.12.2009
Doli nga shtypi më 14.12.2009

Tirazhi: 3300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 36 lekë